

# DEMOKRACIA TË JEP FUQI



## NE E DUAM DEMOKRACINË

BEHXHET (10), GRESA (10), RINOR (11), OLSA (11), QENDRIM (10), RINESA (11)



### Në Kosovë, qytetarët e ushtrojnë sovranitetin e tyre duke i votuar kandidatët për deputetë

Ne grupi „Inteligjentët“, sot mësuam për një temë shumë të rëndësishme, e ajo është demokracia.

Fjala demokraci e ka kuptimin e qeverisjes së popullit, ku vet qytetarët vendosin për të ardhmen e shtetit. Ndër format më të përhapura të demokracisë janë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Në shtetin tonë, pra në Kosovë, në fuqi është demokracia përfaqësuese me sistem parlamentar.

Demokracia ka shumë elemente pozitive, elemente të cilat, edhe ne si qytetarë të Kosovës i posedojmë. Ato janë: toleranca, solidariteti, respekti, barazia, etj.

Ne, qytetarët e Kosovës jemi tolerantë, sepse jetojmë së bashku me komunitetet jo shumicë, e kjo dëshmon se në Kosovë ka demokraci të mirëfilltë.

Ne dëshirojmë ta ndajmë me ju një rast të veçantë i

cili i ka ndodhur një shoqes së klasës sonë, Gresa. Ishte ditë me shi, kur rrugës duke shkuar në shkollë, Gresa takoi një person me nevoja të veçanta, i cili nuk mundi ta frenonte karrocën e tij. Në atë çast, karroca filloi të ecte me shpejtësi të madhe përpara, ndërsa ai po kërkonte ndihmë. Gresa vrapoi pas karrocës dhe si përfundim, karroca ndaloi me ndihmën e disa qytetarëve të tjerë. Kjo tregon që Gresa ka bërë një vepër solidariteti, e cila është njëra prej elementeve kyçe të demokracisë.

Ne kemi një mesazh për ju lexues të dashur: bëhuni tolerantë, tregoni respekt për njëri-tjetrin dhe solidarizohuni me personat që kanë nevojë për ju, sepse kështu do ta kemi një jetë më të mirë dhe më të lumtur.



Gazetarët e Kosovës



Puna në grup

# DEMOKRACIA DHE PROCESI ZGJEDHOR

ARBENITA (11), MEDINA (11), ERZA (10), ALBION (11), AID (11), LEON (10)

## Në këtë artikull mund të lexoni për demokracinë dhe zgjedhjet


Demokracia është udhëheqje e popullit. Në demokracinë përfaqësuese, populli voton përfaqësuesit e vet, të cilët do ta udhëheqin vendin.

Në jetën e përditshme kemi të drejtën për t'u shprehur lirshëm dhe për të zgjedhur gjëra të ndryshme, si p.sh.: rrobat, librat, kanalet e televizionit, etj. Mirëpo, për të marrë pjesë në procesin zgjedhor duhet t'i mbushim 18 vjet, sepse atëherë do të jemi më të pjekur dhe më të vetëdijshëm për vendimet që i marrim. Kemi dy lloje zgjedhjesh dhe ato janë: zgjedhjet komunale dhe zgjedhjet qendrore.


Kosova është një vend demokratik, ku populli i zgjedhë deputetët si përfaqësues. Ne mendojmë se vota është shumë e rëndësishme, sepse me anë të votës ne zgjedhim ata, të cilët do të na udhëheqin.



Demokratët e së ardhmes



Duhet të votojmë sipas dëshirës tonë



Qytetarët duke shprehur mendimet e tyre



Ne mësojmë për demokracinë në Punëtorinë „Demos-ti“



Të gjithë i kemi të drejtat e barabarta



## KUVENDI I KOSOVËS, VEND I TOLERANCËS

BLERINA (11), ERZANA (10), BUNJAMIN (11), ENIDA (11), REIS (10), ALTIN (10)



### Lexues të dashur, sot do të mësoni se çfarë rëndësie ka Kuvendi i Kosovës në jetën tonë të përditshme

Kuvendi i Kosovës luan një rol të rëndësishëm në jetën tonë. Në Kuvend merren ligje të ndryshme, të cilat ndikojnë në të ardhmen e vendit. Disa nga ligjet më të rëndësishme që ndikojnë në jetën tonë të përditshme janë: ligjet për arsim, ligjet për shëndetësi, infrastrukturë, ekonomi, etj.

Kuvendi është institucioni më demokratik, sepse zbaton të gjitha elementet e demokracisë, të cilat janë të shumta. Ky institucion ka rolet dhe përgjegjësitë e veta. Prej Kuvendit të Kosovës propozohen dhe miratohen ligjet.

Tri funksionet e Kuvendit janë: funksioni përfaqësues, funksioni legjislativ dhe funksioni kontrollues. Kuvendi ka funksion përfaqësues, sepse na përfaqëson ne popullin; ka funksion legjislativ, sepse Kuvendi miraton ligjet; dhe ka funksion kontrollues sepse e


kontrollon Qeverinë nëse është duke i zbatuar ligjet e miratuara në Kuvend.

Në Kuvend punojnë gjithsej 120 deputetë, të cilët falisin në emër të të gjithë qytetarëve.

Në mënyrë që Kuvendi ta ketë punën më të lehtë, duhet që edhe roli ynë të jetë sa më aktiv. Për shembull, ne duhet t'i zbatojmë ligjet e marra në Kuvend, duhet të marrim iniciativa pozitive për vendin, e po ashtu duhet t'i ndihmojmë sa më shumë njerëzve të tjerë.

Ne jemi shumë të lumtur që kemi marrë pjesë në Puntorinë e Demokracisë, sepse kemi marrë shumë informata, të cilat do të na shërbejnë për të ardhmen. Mesazhi ynë për ju është: bëhuni qytetarë aktiv, sepse ju mund të ndryshoni vendin tuaj.

Pjesëmarrja juaj aktive mund të bëjë ndryshime të mëdha, andaj bëhu edhe ti pjesë e ndryshimit.



Në Kuvend diskutohen çështje të ndryshme



Ne jemi e ardhmja e vendit

# ROLI I DEPUTETËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

RUMEJSA (10), YLLKA (10), ADELA (11), BLENDINA (11), ARIANIT (11), RINOR (11)

**Cili është roli i deputetëve të Republikës së Kosovës? Kush i zgjedh këta deputetë? Nga cila moshë e kemi të drejtën e votës? Këto informata do t'i mësoni në artikullin më poshtë**


Deputetët janë përfaqësuesit e popullit, të cilët për rol kanë përfaqësimin e interesave të popullit në Kuvend. Këta përfaqësues zgjedhen nga votat e qytetarëve. Qytetarët para se të votojnë, mendojnë mirë se cilët janë personat e duhur për të përfaqësuar vendin. Të drejtën për të votuar dhe për t'i zgjedhur deputetët e kemi nga moshë 18 vjeçare. Pra, përmes votës sonë ne iu japim fuqi deputetëve, të cilët punojnë në Kuvend dhe të cilët propozojnë dhe miratojnë ligjet. Mandati i deputetëve është 4 vjeçar, me mundësi vazhdimi edhe për mandatet e ardhshme, nëse populli mendon se ai deputet e ka përfaqësuar popullin në mënyrën më të mirë të mundshme. Prandaj, prej neve gjithmonë kërkohet që të jemi qytetarë të përgjegjshëm, sepse vetëm kështu e ngrisim dhe e zhvillojmë vendin tonë.




Ne vendosim për të ardhmen tonë




Të gjithë jemi të barabartë



Deputetët janë përfaqësuesit tanë



Deputetët punojnë në Kuvend



Kandidati për deputet duke folur para popullit





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Naim Frashëri“  
Klasa: V-4  
Vendi: Vushtrri